Konferenca VI Ndërkombëtare e Arkivistikës
organizuar me bashkëpunimin e
Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave - Tiranë (Shqipëri),
Agjencisë Shtetërore të Arkivave - Prishtinë (Kosovë)

# FTESË PËR PJESËMARRJE

**Datat:** 10-11 qershor 2022
**Vendi:** Boletin, Kosovë
**Afati i pranimit të kumtesave përfundon më 1 prill 2022**.

Pas konferencave të zhvilluara në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Sarandë dhe Tuz, arkivistët nga të gjitha trevat do të mblidhen këtë herë në Boletin të Kosovës.

Ky aktivitet organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Qëllimi i kësaj konference është të mbledhë ekspertët dhe studiuesit e arkivave të vendeve shqipfolëse dhe të arkivave të rajonit, të cilët diskutojnë çdo vit për problematikat, metodologjinë e studimit, dixhitalizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së përmbajtjes, inovacionin, si dhe vizionit të punës së arkivave në realitet e sotme.

Me këtë rast Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe ftojnë studiuesit, nëpunësit dhe të gjithë të interesuarit e kësaj fushe të marrin pjesë në konferencë me studime, ide dhe propozimet e tyre.

Temat që propozohen për diskutim lidhen specifikisht me arkivistikën, të drejtat e njeriut dhe me historinë e arkivave apo institucioneve arkivore në zonat shqipfolëse.

Veç arkivistëve të rrjeteve arkivore kombëtare, ftesa për pjesëmarrje u drejtohet të gjithë profileve të tjerë të arkivistëve, institucioneve që ruajnë apo atyre që ndërveprojnë me ruajtjen e kujtesës kolektive.

Abstraktet jo më shumë se 300 fjalë pranohen deri më datë 1 prill 2022 në gjuhën shqipe ose anglisht në dpa@arkiva.gov.al dhe ark.kosoves@rks-gov.net.

Për më shumë informacion shikoni njoftimin ne faqet web të DPA www.arkiva.gov.al dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës asha-ks.net/

**Gjuha e kumtesave:** shqip, gjuhët e Europës Perëndimore.

**Tema të propozuara:**

- Crowdsourcing: konteksti dhe metadatat e dokumenteve të krijuara prej përdoruesit
- Automatizimi i arkivave dhe etika
- Siguria kibernetike dhe administrimi i të dhënave
- Risitë digjitale dhe shfrytëzimi i dokumentacionit
- Zhvillimi i njëtrajtshëm përmes bashkëpunimit me komunitetin
- Trashëgimia arkivore e përbashkët, përtej kufijve politik
- Arkivat, përgjegjësia, aksesi në të dhënat dhe mbrojtja e të dhënave personale
- Bashkëpunimi rajonal në fushën e arkivave dhe trashëgimisë kulturore arkivore
- Trafiku ilegal i trashëgimisë dokumentare
- Etika dhe arkivat

- Ndryshimet klimaterike dhe arkivat
- Trajnimi arkivor dhe përmirësimi profesional
- Turizmi dhe promovimi i arkivave

(*Shënim: temat e propozuara nuk janë tituj të detyruar temash apo artikujsh, as kanë qëllim kufizues, por vetëm sugjerime tematike.*)